

ATASHIMI, ATRIBUIMI DHE VËMENDJA NDAJ INFORMACIONIT SOCIAL NË  
ADOLESHENCË

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER SHKENCOR NË PSIKOLOGJI FEMIJËRORE DHE SHKOLLORE

NGA  
BESA SHALA KRASNIQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PSIKOLOGJI FEMIJËRORE DHE SHKOLLORE

PRISHTINË , 2022

# ATASHIMI, ATRIBUIMI DHE VËMENDJA NDAJ INFORMACIONIT SOCIAL NË ADOLESHENCË

nga

BESA SHALA KRASNIQI

Mentori: Aliriza Arënlju Prof..Asoc.Dr.

Qëllim parësor i këtij studimi ishte të hulumtoj lidhjen e stilit të pasigurt të atashimit prindërorë me atashimin ose kualitetin e marrëdhënies në adoleshencë si dhe ndërlidhjen e stilit të atashimit me stilin negativë/pesimistike të atribuimit. Po ashtu, studimi hulumton ndërlidhjen në mes të stilit negativë të atribuimit dhe ndikimin e tij në arritshmëritë e adoleshentit në shkollë. Studimi ka hulumtuar po ashtu ndërlidhjen në mes të stilit të pasigurt të atashimit me vëmendjen negative të adoleshentit ndaj informacionit social.

Hulumtimi u realizua në mënyre fizike përmes vetëadministrimit të pyetësorëve; Pyetësori Demografik, Inventarin e Atashimit të adoleshentëve IPPA, Pyetësorin e Stilit të Atribuimit të Fëmijëve CASQ dhe vlerësimin e vëmendjes ndaj informacionit social përmes gjashtë artikujve. Në hulumtim u përfshin dyqind (200) pjesëmarrës. Mesatarja e moshës ka qenë 16.31, të gjinisë mashkullore ishin 42.3%, kurse të gjinisë femërore 57.7%.

Teoricienët e atashimit kanë propozuar se zhvillimi i atashimit të sigurt të fëmijës ndaj kujdestarit është një moment i rëndësishëm i zhvillimit që përcakton trajektoren e fëmijës për arritjen e mirëqenies emocionale dhe sociale. Sikurse statet tjera të zhvillimit, strategjitë e atashimit në adoleshencë janë të lidhura me shume aspekte të funksionimit psiko-social. Adoleshenca është periudhe me ndryshime të shpejta neurologjike, kognitive dhe sociale. Tranzicioni I shëndoshë në autonomi dhe pjekuri është e lehtësuar nga atashimi I sigurt dhe lidhja emocionale me prindërit. Atashimi prind-adoleshent luan rol të rëndësishëm në funksionimin kognitive, emocional dhe social. Atashimi I sigurt është I lidhur me përfshirje më të ulët në sjellje të rrezikshme, më pak probleme mendore, dhe fuqizon shkathtësitë sociale dhe strategjitë e përballimit të adoleshentit. Adoleshentet me atashim të sigurt po ashtu, vuajnë më pak nga problem të shëndetit mendore sikurse ankthi, depresioni, çrregullime të sjelljes, delikuencë dhe sjellje agresive.

Fëmijët te cilët kanë stil të sigurt me prindërit parashihet që edhe marrëdhëniet tjera si të rritur do të ndërtojnë mbi bazën e atashimit prind-fëmijë. Gjetjet nga disa studime mbështesin idenë që atashimi i prindërve është i lidhur me procesimin e informacionit social të fëmijëve. Shumë studime të perceptimit dhe atribuimit të fëmijëve mbështesin deklarinë që fëmijët perceptojnë të tjerët në një mënyrë skematike si funksion i atashimit.

Stili i shpjegimit, mënyra se si personi shpjegon shkakun e ngjarjeve pozitive ose negative, është proces kognitivë nga i cili të mësuarit e pashpresës është modeluar. Individëve të cilët stili i shpjegimit është i karakterizuar nga atribuime negative tregojnë rezultate më të ulta të suksesit shkollorë.

Duke u mbështetur në qëllimet e hulumtimit dhe shqyrtimin e literaturës së mësipërme, parashtruam tri hipoteza:

*Hipoteza 1:* Adoleshentët me stil të pasigurt të atashimit prindërorë do të kenë atashim të pasigurt me bashkëmoshatarët.

*Hipoteza 2 :* Adoleshentët me stil të pasigurt të atashimit me prindërit dhe bashkëmoshatarët do të kenë stil negativë të atribuimit në krahasim me ata me atashim të sigurt.

*Hipoteza 3 :* Adoleshentët me stil të atribuimit negativë do të kenë arritshmëri akademike më të ulët.

*Hipoteza 4:* Adoleshentët me stil të pasigurt të atashimit prindërorë dhe me bashkëmoshatarë zgjedhin të ndjekin më tepër informacionin social me përmbajtje negative në krahasim me adoleshentët me atashim të sigurt.

Për të dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të konfirmuar hipotezat e studimit, janë performuar analizat e korrelacionit, përmes Paketës Statistike për Shkencat Sociale (SPSS).

Në bazë të rezultateve të studimit themi se kemi korrelacion në mes të atashimit të pasigurt prindërorë dhe atij të bashkëmoshatarëve ( $r=0.168^*$ ,  $p\text{-value}=0.017$ ) e cila tregon se sa më i lartë të jetë atashimi i pasigurt prindërorë, aq më i lartë do të jetë atashimi i pasigurt me bashkëmoshatarët e tyre.

Rezultatet e studimit tregojnë po ashtu, se adoleshentët të cilët kanë atashim të pasigurt prindërorë, kanë një korrelacion signifikante me atribuimin negativë ( $r=0.466^{**}$ ,  $p\text{-value}=0.00$ ) e cila tregon se ky atashim i pasigurt prindëror ka ndikim signifikante në rritjen e atribuimeve negative, ndërsa adoleshentët që kanë atashim të sigurt prindërorë, nuk ka ndonjë korrelacion pra kjo realisht ndikon në uljen e atribuimeve negative.

Rezultatet e studimit tregojnë se adoleshentët të cilët bëjnë atribuime negative, kanë një korrelacion signifikante me suksesin e dobët shkollorë ( $r=0.104^{**}$ ,  $p\text{-value}=0.155$ ) e cila tregon se adoleshentët me atribuime negative kanë ndikim signifikante në suksesin e dobët shkollorë. Edhe në këtë rast adoleshentët me stil negativ të atribuimit tregojnë rezultate me te ulëta akademike.

Rezultatet e studimit tregojnë për një lidhje jo të rëndësishme statistikore apo korrelacion jo signifikant në mes të atashimit të pasigurt dhe artikujve negativë ( $r=-0.068$ ,  $p\text{-value}=0.344$ ) dhe artikujve pozitivë ( $r=-0.068$ ,  $p\text{-value}=0.344$ ), e cila është më e lartë se niveli i margjinës së gabimit 0.05. Pra, në këtë rast adoleshentët me atashim të pasigurt prindërorë nuk zgjedhin të ndjekin me tepër informacion social me përmbajtje negative.

Duke u bazuar në të dhënat teorike dhe praktike në këtë fushë, është shumë me rëndësi të aplikohen programe të edukimit të cilat mbështesin atashimin përgjatë periudhës së tranzicionit nga shkolla fillore tek e mesme përmes programeve të cilat lidhin të rinjtë me mësuesit, strukturimin e klasave të cilat inkurajojnë lidhjen, dhe edukimin e prindërve, e cila ndihmon në uljen e braktisjes së shkollimit në këtë periudhë të rëndësishme të zhvillimit. Tek adoleshentët me atribuime negative të administrohen trajnime të cilat ndihmojnë në ndryshimin e kognicioneve negative të cilat sipas studimeve të shumta ndikojnë në suksesin e dobët shkollorë të cilën e ka mbështet studimi ynë dhe studime të cilat janë bërë dhe që tregojnë për ndikimin e stilit negativë të atribuimit në shfaqjen e depresionit, po ashtu.

Është esenciale për profesionistët e shëndetit mendorë dhe profesionistët tjerë të edukimit të kenë njohuri mbi fazën zhvillimit në adoleshencë, vlerën dhe rëndësinë e atashimit prindërorë adoleshentë.